

VENDIM
Nr. 852, datë 29.12.2021

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMET E LEGALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, për sipërfaqen takuese, të zënë nga objekti i legalizuar në drejtorinë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Jug, në emër të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH).

2. Vlera e kompensimit financiar është 4 557 240,45 (katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet presje dyzet e pesë) lekë, për sipërfaqen 68,05 (gjashtëdhjetë e tetë presje zero pesë) m², sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurisë së paluajtshme nr. 7/465, zona kadastrale 8270, sipas seksionit të veçantë (kolona 19) të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, sipas pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

4. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë, nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen.

5. Drejtoria vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Jug të kryejë ndryshimet përkatëse për këtë pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

6. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca nr.1

Agjencia Shtetërore e Kadastrës

Lista emërore e subjekteve që preken nga ndërtimet informale të kualifikuara, masa dhe vlera e shpërblimit

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Gjendja juridike (pronesia)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Numri i Pronareve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve								
Nr Rendor	Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit						Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
				Numer	Date													
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
TIRANE JUG																		
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8270																		
1	REPUBLIKA E SHQIPËRISË / FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)			1438	08.10.2021	TE VET +TE TRETEVE			1	E PAPERCAKTUAR	1	7/465	68.05	66,969	4,557,240.45	REGJISTROHET KERKËSE PADIA Nr. 00050436 Dt.11/11/2021 VERTETIM GJYKATA RRETHIT GJYQESOR TIRANE		
																MBI KETE TRUALL ESHTE NDERTUAR PALLATI NR.7/637. E VLEFSHME PER KONTRATE SHKEMBIMI Nr. Dok. 00029613 Dt.10.03.2015		